



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 25, datë 23.03.2020

**“PËR
AMENDIMIN E KONTRATËS ME OPERATORIN E TRANSPORTIT PUBLIK
SHOQËRINË “SHPRESA AL”, NË KUADËR TË MARRJEVE TË MASAVE GJATË
KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19, PËR OFRIMIN E KËTIJ SHËRBIMI NË FUNKSION TË PERSONELIT
DHE STAFIT MJEKËSOR”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5/1 të Aktit normativ nr. 3, datë 16.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, nenit 13, nenit 14, nenit 15, nenit 17 dhe nenit 19 të Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

- Miratimin e amendimit të kontratës nr.46412 datë 23.12.2017 të diktuar nga situata emergjente me operatorin e transportit publik shoqërinë “Shpresa Al”, për linjën **Tiranë – Kamëz**, në kuadër të marrjeve të masave gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, për ofrimin e këtij shërbimi vetëm në funksion të personelit dhe stafit mjekësor, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- Itenerari i linjës sipas miratimit në Udhëzimin nr.5628, datë 18.11.2016 e Ministrisë së Transportit e Infrastrukturës “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, të ndryshuar,

me stacione 1) Qendër Kamzë, 2) Bathore, 3) Institut, 4) Ura Insitutit 5) Casa Italia 6) sheshi shqiponja 7) Kryqëzimi rrugës “Dritan Hoxha me rrugën “Lord Bajron” 8) Sheshi “Karl Topia” 9) Stacioni pas Muzeut Kombëtar.

- Shërbimi i transportit publik qytetas për linjën e parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi, do të ofrohet nga shoqëria “Shpresa AI”, për gjithë kohëzgjatjen e periudhës së shkaktuar nga infeksioni Covid 19 dhe deri sa funksionimi normal i transportit publik do të qëndroj i pezulluar.
- Shpenzimet për ofrimin e këtij shërbimi mbuloohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2020 të miratuara për këtë qëllim.
- Amendimi kontratës sipas këtij vendimi nënshkruhet nga zëvendëskryetari i bashkisë në cilësinë e autoritetit kontraktor të Bashkisë Tiranë.
- Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI

TONI GOGU



REPUBLICA E SHqipërisë
BASHKIA TIRANË